

URDHËR
Nr. 448, datë 31.12.2020

**PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË BORDIT DISIPLINOR TË DHOMËS
KOMBËTARE TË NOTERËVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të shkronjës “a”, të pikës 1 dhe të pikës 2, të nenit 42, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, si dhe të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 169, datë 10.6.2020, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Bordit Disiplinor”,

KONSTATOJ:

Në zbatim të kërkesës për shprehje të interesit të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr. 6547, datë 19.10.2020, janë paraqitur kandidaturat të cilat kanë shprehur interes për t’u zgjedhur si anëtar i Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë, në referim të pikës 1, të nenit 42, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, ku 2 anëtarë zgjidhen nga ministri i Drejtësisë.

Në zbatim të urdhrit nr. 369, datë 6.11.2020, “Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë”, është vijuar me trajtimin e kandidaturave të paraqitura dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore.

Dokumentacioni i paraqitur nga znj. Jonida Gaba është protokolluar nga Ministria e Drejtësisë me nr. 6547/1 prot., datë 2.11.2020, i cili është dërguar brenda afatit ligjor të përcaktuar në shprehjen e interesit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton, se eksperiencia e krijuar pranë studios ligjore “Haxhia & Hajdari”, duke vazhduar me punën pranë studios ligjore “Freshfields Bruckhaus Deringer”, në Milano, duke u specializuar në trajtimin e problematikave ligjore në fushën e së drejtës tregtare dhe administrative për llogari të kompanive ndërkombëtare, duke vijuar si eksperte ligjore pranë shoqërisë “Nomura International p.l.c.”, në Milano, në fushën e investimeve financiare, si dhe duke parë kontributin e saj të dhënë në lidhje me implementimin në një mënyrë sa më efikase të reformës në drejtësi, kërkesja plotëson kriteret e parashikuara nga neni 42, pika 2, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”.

Bazuar në eksperiencën e provuar profesionale në çështjet e së drejtës civile, si dhe meritat profesionale të kërkuësës,

URDHËROJ:

1. Zgjedhjen e znj. Jonida Gaba, si anëtare të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë.
2. Mandati si anëtare e Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë, fillon në datën 1.1.2021 dhe përfundon në datën 31.12.2026.
3. Subjektet e interesuara mund të paraqesin ankim administrativ pranë ministrit të Drejtësisë, brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit, sipas pikës 11 të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 169, datë 10.6.2020, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterëve”, të ndryshuar.
4. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave dhe njoftimin e këtij urdhri, znj. Jonida Gaba, Dhomës Kombëtare të Noterisë, si dhe Shkollës së Magjistraturës.
5. Ky urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjona (Saliu)